



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 27.06.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Botek" shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative", Nr. i prokurimit- 632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060-558, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Botek" shpk, e dt.27.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative", Nr. i prokurimit- 632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060 -558", kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 22.06.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 22.06.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.27.06.2023, Operatori Ekonomik "Botek" shpk, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative", Nr. i prokurimit-632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060 -558.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pa bazuar, sepse Deklarata për specifikime teknike nga Operatori ekonomik fitues është plotësuar sipas kërkesës së Autoritetit kontraktues në Ftesën për Ofertim.

Dokumenti që pretendoni ju që Operatori ekonomik nuk e ka plotësuar nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik fitues, ka plotësuar përshkrimin e çmimeve sipas kërkesës së Autoritetit kontraktues në FPO-së.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës